



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 15.01.2025, nxjerr këtë:

### **VENDIM**

#### **Për Miratimin e Procedurave të Votimit dhe Numërimit në Vendvotim**

- I. Miratohen Procedurat e Votimit dhe Numërimit në Vendvotim, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- II. Procedurat si në pikën I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.01.2025

**Kreshnik RADONIQI**  
  
Kryesues i KQZ



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

# PROCEDURAT E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT NË VENDVOTIM



# Përmbajtja

<b>I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E SISTEMIT ZGJEDHOR</b>	<b>5</b>
SISTEMI DHE ZGJEDHJET NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	5
<b>II. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PJESËMARRËSVE NË PROCES ZGJEDHOR</b>	<b>6</b>
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE	6
KOMISIONI KOMUNAL I ZGJEDHJEVE	6
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)	7
VËZHGESIT DHE MEDIAT	8
ROLI I POLICISË	10
QENDRAT E VOTIMIT DHE PERSONELI	10
PERSONELI I QV DHE PËRGJEGJËSITË	11
KËSHILLI I VENDVOTIMIT (KVV)	12
<b>III. PËRGATITJET PËR VOTIM</b>	<b>25</b>
PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE	25
DITA E ZGJEDHJEVE	30
NË DITËN E ZGJEDHJEVE	31
<b>IV. PROCESI I VOTIMIT</b>	<b>33</b>
PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E VOTIMIT	33
VOTIMI I RREGULLT	33
<b>V. MBYLLJA E QENDRËS SË VOTIMIT DHE VENDVOTIMIT</b>	<b>35</b>
MBYLLJA E QENDRËS SË VOTIMIT	35
MBYLLJA E VENDVOTIMIT (19:00)	35
<b>VI. NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE DHE PËRPUTHJA E REZULTATEVE</b>	<b>36</b>
NUMËRIMI I VOTAVE TË SUBJEKTEVE POLITIKE	37
<b>VII. FFORMULARI I REZULTATEVE, PAKETIMI NE VV DHE TRANSPORTI NË KKZ/QKN</b>	<b>39</b>
PAKETIMI NË VENDVOTIM	39
<b>VIII. TRANSPORTI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA KVV NË DEPO KOMUNALE/QKN</b>	<b>40</b>
SHTOJCA 1: Formular i Rezultateve të Subjekteve (FRS)	42
SHTOJCA 2: Formular i Dorëzimit - Pranimit	43
SHTOJCA 3: Diagrami i paketimit	44
SHTOJCA 4: Dokumentet e pranueshme të identifikimit	45
SHTOJCA 5: Formular i ankesës I PZAP-së	46
SHTOJCA 6: Udhëzues për regjistrimin në kamerë në VV	48

## Lista e akronimeve

KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

SKQZ - Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

KKZ - Komisioni Komunal i Zgjedhjeve

ZEKKZ - Zyrta Ekzekutiv i Komisionit Komunal Zgjedhor

KVV - Këshilli i Vendvotimit

PZAP - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

QKN - Qendra Komunale e Numërimit

QV - Qendra e Votimit

VV - Vendvotimi

LV - Lista e Votuesve

LVK - Lista e Votuesve me Kusht

FRS - Formulari i Rezultateve të Subjekteve

DI - Dokument Identifikues

# PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E SISTEMIT ZGJEDHOR

## SISTEMI DHE ZGJEDHJET NË REPUBLIKEN E KOSOVËS

### Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës

Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës kanë sistem proporcional përfaqësimi me lista të hapura.

Kjo do të thotë se çdo subjekt politik fiton një numër ulësesh në Kuvend, që është afërsisht ekuivalent me proporcionin e numrit total të votave të vlefshme në zgjedhje.

Kosova është një zonë zgjedhore ku subjektet e certifikuar për zgjedhje garojnë për 120 ulëse në Kuvendin e Kosovës.

Nga 120 ulëse në Kuvend, 10 janë të garantuara për pjesëtarët e komunitetit serb, si dhe 10 për pjesëtarët e komunitetit tjera që nuk janë shumicë.

Në sistemin proporcional të përfaqësimit me lista të hapura që përdoret në Kosovë, nëse një subjekt politik fiton x ulëse, kandidatët nga ai subjekt me numrin më të lartë të votave marrin ato ulëse.

Megjithatë, kriteri në Kosovë është që së paku 30% të përfaqësuesve të secilit subjekt politik duhen të jenë nga secila gjini dhe ky është kriter obligues, i cili duhet të aplikohet edhe në ndarjen e ulësive për kandidatë.

Pragu 5% për subjektet politike do të thotë se subjektin politik duhet të fitojë së paku 5% të votave të vlefshme për të pasur të drejtë të fitojë ulëse përfaqësuese në Kuvend. Subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet pakicë nuk kanë nevojë të përmbushin këtë kriter.

Votuesi voton një subjekt politik dhe dhjetë (10) kandidatë të atij subjekti politik.

Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seances konstituive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.

**Sistemi** - Proporcional me listë të hapur (1 votë për Subjektin politik dhe 10 kandidatë të atij S.P.)

**Zona zgjedhore** - Kosova një Zonë Zgjedhore

**Kuvendi i Kosovës** - 120 ulëse

**Ulëset e garantuara** - 10 për pjesëtarët e komunitetit serb, si dhe 10 për pjesëtarët e komuniteteve pakicë

**Pragu 5% për subjektet politike** - do të thotë se subjektin politik duhet të fitojë së paku 5% të votave të vlefshme për të pasur të drejtë të fitojë ulëse përfaqësuese në Kuvend. Subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet pakicë nuk kanë nevojë të përmbushin këtë kriter.

**Kuota gjinore prej 30%** - siguron që së paku 30% e kandidatëve të secilit subjekt politik të jenë nga secila gjini dhe ky është kriter obligues, që aplikohet edhe në ndarjen e ulësive për deputetë në Kuvend.

## II TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PJESËMARRËSVE NË PROCES ZGJEDHOR

Në këtë kapitull do të mësojmë për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e akterëve të ndryshëm që marrin pjesë në një proces zgjedhor në Republikën e Kosovës. Akterët i ndajmë në dy grupe, të brendshëm dhe të jashtëm. Akterët e brendshëm përbëjnë strukturën organizative, apo trupin menaxhues të zgjedhjeve ku hynë: KQZ, KKZ, Menaxherët e Qendrave dhe KVV; ndërsa akterët e jashtëm përfaqësohen nga Subjektet politike/Vëzhguesit, Mediat si dhe institucioni i Policisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) është organ i përhershëm, i pavarur dhe kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

### KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucion i pavarur kushtetues, përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës.

KQZ përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë: nga Kryesuesi dhe dhjetë (10) anëtarë. Kryesuesi, emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe gjykata me juridiksion apeli. Mandati i Kryetarit të KQZ-së është (7) vjet, duke filluar nga data e caktuar për njoftim të emërimit nga Presidenti i Kosovës. Kompetencat e ushtrimit të detyrës së anëtarit të KQZ-së, caktohen në bazë të ligjit dhe rregullat për ushtrimin e mandatit. Dhjetë (10) anëtarët e tjerë të KQZ-së, janë emëruar si rezultat i nominimeve të gjashtë (6) grupeve parlamentare më të mëdha të Kuvendit të Kosovës dhe, katër (4) anëtarë që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë.

### KOMISIONI KOMUNAL I ZGJEDHJEVE

Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) është organ përgjegjës për organizimin e aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të komunës.

Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) janë trupa të themeluara nga KQZ-ja në tridhjetë e tetë (38) komunat e Republikës së Kosovës për të ndihmuar organizimin e zgjedhjeve. KKZ-të janë përgjegjëse t'i administrojnë zgjedhjet përbrenda komunës së tyre, nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së duke garantuar ligjshmëri, legjitimitet dhe efikasitet të procesit zgjedhor. KKZ-të përbëhen nga shtatë (7) anëtarë dhe emërohen brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve. Mandati i KKZ përfundon pesëmbëdhjetë ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, ose sipas dispozitave tjera të përcaktuara në nenin 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 02/2024.

## Përgjegjësitë e KKZ:

- ⇒ KKZ administron zgjedhjet brenda komunës përkatëse;
- ⇒ KKZ harton planin e aktiviteteve zgjedhore brenda afateve për realizimin e tyre, të cilat bëhen publike;
- ⇒ KKZ drejton punën e QKN;
- ⇒ KKZ bën pranimin dhe shpërndarjen e materialit zgjedhor, nga vendvotimet e rregullta, me kusht dhe nga ekipet mobile;
- ⇒ KKZ zbaton procedurat e parapara për fushatë zgjedhore;
- ⇒ KKZ duke ju referuar udhëzuesit për caktimin e menaxherëve dhe personelit teknik të QV, përpilon listën e menaxherëve për QV dhe e përcjellë në KQZ;
- ⇒ KKZ i dorëzon listat e anëtarëve të KVV dhe ekipeve të numërimit në QKN, për miratim në KQZ;
- ⇒ KQZ përmes KKZ organizon fushatë informuese në komuna përkatëse;
- ⇒ KKZ bën raportime në baza ditore në KQZ, sipas formatit të përcaktuar në KQZ.

## Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i përhershëm, i pavarur dhe kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

PZAP-i pranon ankesa në katër faza:

- Ankesa ndaj vendimeve të KQZ
- Ankesa gjatë periudhës parazgjedhore
- Ankesa për shkelje në ditën e zgjedhjeve
- Ankesat gjatë periudhës paszgjedhore

**Afatet:** Gjatë fushatës zgjedhore ankesa duhet të parashtrohet deri në 48 orë pas shkeljes, ndërsa shkeljet që ndodhin në ditën e zgjedhjeve duhet të dorëzohen në PZAP orë pas mbylljes së vendvotimeve.

Kryesuesi i KVV-së është i obliguar të informojë palët e interesuara për të drejtën e tij/saj për të parashtuar ankesë në Panelin e Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) duke i siguruar atij/asaj formularin e ankesës të PZAP-it që ndodhet në tavolinën ndihmëse të QV.

Votuesi duhet të informohet se formulari dorëzohet personalisht, ose me postë në zyrën e PZAP-it në rrugën Rr. „Migjeni“, Ndërtesa e ish Bankës së Lubljanës, kati i parë në Prishtinë.

### Mandati PZAP

- Organ i pavarur
- Menaxhon të gjitha ankesat dhe shkeljet në lidhje me zgjedhjet

**Formular i Ankesës** – dorëzohet sipas afateve ligjore në PZAP

- 48h-shkeljet në Ditën e Zgjedhjeve
- 48h-për shkeljet gjatë fushatës

**Sistemi i Menaxhimit të Rasteve** - Përcjellja e statusit të rastit përmes Sistemit të Menaxhimit të Rasteve (<http://pzap.rks-gov.net>)

**Kontakti** - Rruga Migjeni Nr. 21, Prishtinë. (<http://pzap.rks-gov.net>)

**Vëmendje:** Çdo ankesë që ndërlidhet me procesin e votimit dhe numërimit duhet të dorëzohet në PZAP brenda 24 orëve, nga momenti i shkeljes së supozuar.

**Vendimi** - PZAP ka 72 orë për të marrë vendimin.



## VËZHguesIT DHE MEDIAT

Pjesëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga organizatat e përditshme orientuese nga QKZ, bashkë me bashkëpunëtorët e tyre, duhet të marrin pjesë në përfundimin dhe në kryerjen e punëve të tyre të cilat kanë të bëjnë me punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe me punën administrative të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Numri i bashkëpunëtorëve që mund të marrin pjesë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i kufizuar.

Numri i bashkëpunëtorëve që mund të marrin pjesë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i kufizuar.

### Vëzhguesit e votimit

Vëzhguesit e votimit janë individë të cilët janë të aftë të marrin pjesë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të marrin pjesë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të marrin pjesë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vëzhguesit e votimit duhet të jenë individë të cilët janë të aftë të marrin pjesë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të marrin pjesë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të marrin pjesë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vëzhguesit e votimit duhet të jenë individë të cilët janë të aftë të marrin pjesë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të marrin pjesë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të marrin pjesë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Procedurave Administrative të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në pajtim me procedurat e saj.

Vëzhguesi ka për detyrë të:

- Respektojë kërkesat e këtij ligji dhe rregullat e KQZ;
- Mbjajë distinktivin e identitetit të vëzhguesit në mënyrë të dukshme kur është i angazhuar në aktivitete të vëzhgimit;
- Përmbahet nga bartja e shenjave dalluese të cilat shërbejnë si mjete propaganduese ose që mund të ndikojnë në dëshirën e votuesit ose e identifikon atë me një parti të caktuar politike ose kandidat;
- Përmbahet nga shkelja e të drejtës së votuesit për fshehtësi të fletëvotimit dhe nga pengimi i procesit të të votuarit dhe administrimit të zgjedhjeve.

### Vëzhguesit e mediave

Me rastin e vendimit të procesit të votimit dhe numërimit nga mediat e akredituara, duhet të kihen parasysh:

- Përfaqësit e mediave qëndrojnë në vendin që u caktohet nga kryesuesi në një largësi të përshtatshme nga tavolinat e punës;
- e kanë të ndaluar të kenë kontakt fizik me materialet zgjedhore;
- të mos bëjnë procesin e numërimit të fletëvotimeve apo të komunikojnë me anëtarë të KQZ;
- të mos çelëjnë privatizim dhe fshehtësi të votës.

### **Roli dhe përgjegjësitë e Vëzhguesve të akredituar**

- Mbajnë dhe tregojnë kartelën e akreditimit të lëshuar nga KQZ gjatë qëndrimit në QV/VV
- Respekton dhe u përmbahet rregullave strikte të kodit etik në çdo kohë duke mos ndërhyrë në proces zgjedhor dhe duke mos cenuar fshehtësinë e votës.
- Filmojnë brenda qendrës së votimit/vendvotimit përderisa nuk incizojnë asnjë informatë personale të ndonjë votuesi ose përderisa nuk cenojnë fshehtësinë e votuesve.
- Vëzhgon nga afër procesin e votimit dhe të numërimit.
- I drejtohet vetëm Kryesuesit të KVV-së për të gjitha preokupimet/vërejtjet apo sqarimet.

### **Vëzhguesit nuk kanë të drejtë:**

- të ndërhyjnë dhe pengojë mbarëvajtjen e procesit zgjedhor
- të vëzhgojnë kabinën e votimit përderisa votuesi është duke votuar.
- të japin urdhër dhe të debatojnë me anëtarët e KVV-së lidhur me ndonjë procedurë në VV.
- të ulen në të njëjtën tavolinë me anëtarët e KVV-së.
- të marrin fletëvotimet ose ndonjë material të ndjeshëm që përdoret në VV.
- ti ndihmojnë ndonjë votuesi.
- pasi të ketë filluar procesi i numërimit, vëzhguesit mund të largohen nga vendvotimi, por nuk mund të kthehen dhe të hyjnë më aty pas fillimit të numërimit.
- të flasin drejtpërdrejt me anëtarët e KVV.

### **Roli dhe përgjegjësitë e Mediave**

- Mbajnë dhe tregojnë kartelën e akreditimit të lëshuar nga KQZ gjatë qëndrimit në QV-VV.
- Respektojnë dhe u përmbahen rregullave strikte të kodit etik në çdo kohë duke mos ndërhyrë në procesin zgjedhor dhe duke mos cenuar fshehtësinë e votës.
- Vëzhgojnë procesin e votimit (me përjashtim të shënimit të fletëvotimit nga votuesi), duke mos penguar procesin e zgjedhjeve dhe kufizimin e shfrytëzimit të ndonjë materiali në vendvotim.
- Filmojnë mbrenda QVV-VV duke u perkujdesur se nuk incizojnë asnjë informatë personale të ndonjë votuesi ose përderisa nuk e shkelin fshehtësinë e votuesve.
- Zhvillojnë intervista me votuesit pas votimit të tyre brenda Qendrës së Votimit dhe hapësirës që e rrethon Qendrën e Votimit.

### **Mediat nuk kanë të drejtë të:**

- Filmojnë LV/LVK dhe votuesin brenda kabinës gjatë shënimit të fletëvotimit.
- Të intervistojnë brenda VV.

## ROLI I POLICISË

---

Policia e Kosovës, vendoset afër qendrave të votimit në Ditën e Zgjedhjeve për të trajtuar shpejtë dhe në menyrë efektive të gjitha shkeljet që mund të ndodhin, si mbajtja dhe përdorimi i armës brenda dhe jashtë QV dhe VV, fotografimi dhe postimi i votës në rrjete sociale, si dhe cenimi apo pengimi i mbarvajtjes së procesit zgjedhor

## QENDRAT E VOTIMIT DHE PERSONELI

---

Qendra e Votimit (QV) është ndërtesa në të cilën janë të vendosura një ose më shumë vendvotime (VV) dhe hapësira e jashtme e saj. QV janë ndërtesa të institucioneve publike, me prioritet, objektet arsimore, kulturore, sportive dhe të ngjashme.

Vendvotimi (VV) është klasa, salla ose objekti i ngjashëm i caktuar në QV ku do të zhvillohet procesi i votimit dhe numërimit. Në çdo vendvotim nuk mund të tejkalohet numri i 750 votues, me përjashtim kur autorizohet me vendim të KQZ.



## **PERSONELI I QV DHE PËRGJEGJËSITË**

- Menaxheri i Qendrës
- Personeli i tavolinës ndihmëse

### **Menaxheri i Qendrës**

Një ditë përpara dhe në Ditën e Zgjedhjeve, Menaxheri i Q.V. është përgjegjës për organizimin dhe planifikimin e të gjitha aktiviteteve teknike në Qendrën e Votimit dhe jashtë ndërtesës.

### **Menaxheri i QV është përgjegjës për aktivitetet si në vijim:**

- Pranimin e pakos së materialeve jo të ndjeshme të QV.
- Orientimin, qarkullimin dhe qasjen e votuesve në QV.
- Raportimin tek KKZ për mbarëvajtjen dhe gjendjen në QV.
- Evidentimi në librin e evidencës
- Pranimin e materialit të Zgjedhjeve për QV dhe materialit jo të ndjeshëm për VV.
- Shpërndan materialet jo të ndjeshme për kryesuesit e KVV.

### **Personeli i Tavolinës Ndihmëse**

Çdo QV, do të ketë të paktën një tavolinë ndihmëse, ku do të shpërbejnë zyrtarët, të cilët do të jenë të pajisur me LV në formatin elektronik.

Detyrat dhe përgjegjësit e Personelit të Tavolinës ndihmëse:

- informimi dhe orientimi i votuesve se ku dhe në cilin vendvotim janë të caktuar të votojnë.
- duhet të jetë e pajisur me formularët për ankesa dhe parashtresa që i drejtohen PZAP, nëpërmjet të cilave votuesit mund të ankohen në PZAP gjatë ditës së votimit në rast se kanë vërejtje.
- duhet të jetë e pajisur me shabllone me

alfabetin e brajl-it për t'iu shërbyer votuesve të verbër.

- raporton për pjesëmarrjen e votuesve
- raportimin e rezultateve preliminare, bazuar në të dhënat e KVV, sipas udhëzimeve nga KQZ.
- pas përfundimit të numërimit në KVV, kryesuesi i KVV e dorëzon kopjen e katërt (4) të verdhe të FRS tek zyrtari i tavolinës ndihmëse për futjen e të dhënave të rezultateve preliminare.

## KËSHILLI I VENDVOTIMIT (KVV)

---

Këshilli i Vendvotimit është trup menaxhues zgjedhor, i themeluar nga KQZ, i cili është përgjegjës për përgatitjen dhe administrimin e procesit zgjedhor në VV.

Përbërja e KVV reflekton strukturën e anëtarëve të KKZ. Ekipi i KVV duhet të ketë 5 anëtarë, por ka raste kur me vendim të KKZ, vendvotimi mund të hapet edhe me 3 anëtar për të funksionuar procesi zgjedhor.

### POZITAT DHE FUNKSIONET E KVV

- Kryesuesi i KVV,
- Kontrolluesi i rreshtit,
- Zyrtari i identifikimit,
- Zyrtari i të dhënave statistikore
- Dhënësi i fletëvotimit,

Në rastet kur kemi më shumë se 5 anëtar, në një KVV atëherë, funksionet e tyre janë si në vijim:

- Anëtari i 6 kryen funksionin e shënjesit të ngjyrës matrikuluese.
- Anëtari i 7 kryen funksionin e mbikëqyrësit të kutisë së votimit.

## KRYESUESI I KVV

Kryesuesi i KVV është përgjegjësi kryesor që ushtron detyrën në mënyrë profesionale dhe të paanshme në menaxhimin dhe funksionimin e përgjithshëm të vendvotimit duke kryer detyrat/punën me saktësi dhe në përputhje me rregullat dhe procedurën e miratuar në KQZ-së.

### **Kryesuesi është përgjegjës për:**

- Zbatimin e të gjitha procedurave të votimit, numërimit dhe paketimit me përpikëri.
- Cakton detyrat e të gjithë anëtarëve të KVV-së.
- Kur has në paqartësi procedurale Ditën e Zgjedhjeve, duhet ti referohet procedurave të votimit, numërimit dhe paketimit/ manualit të miratuara nga KQZ.
- Menaxhon dhe mbikëqyrë të gjitha operacionet brenda VV
- Mban kontakte me mediat, vëzhguesit e akredituar dhe personelin e sigurisë që vijnë në VV
- Kontakton/komunikon me KKZ-në për çështje operative.
- Kryesuesi i Vendvotimit është i obliguar që 5 (pesë) minuta para kohës së raportimit në ora 09:00, 11:00, 13:00, 15:00 dhe 19:00 ti ofroj të dhënat-statistikat e përqindjes së daljes së votueseve në atë vendvotim tek tavolina ndihmëse e QV-së.
- Plotëson formularin me të dhënat e përqindjes së daljes në votim dhe ia jep personelit për rezultate preliminare i cili nënshkruhet nga të dy palët.
- Pas përfundimit të numërimit të votave për subjektet politike, kopja e verdhë e FRS-së duhet ti dorëzohet personelit për rezultate preliminare në QV tek tavolina ndihmëse e QV-së.

- Kryesuesi i Vendvotimit raporton te Menaxheri i Qendrës së Votimit për:
  - a) Hapjen e VV në ora 07:00;
  - b) Daljen e votuesve në zgjedhje duke raportuar numrin total të votuesve në këto intervale:
    - 11:00 raporton numrin e votuesve
    - 15:00 # votuesve
    - 19:00 # votuesve dhe mbyllja e VV
  - c) Mbylljen e QV 19:00
- Kujdeset për ruajtjen e të gjithë materialit zgjedhor në VV

Për vendvotimet të cilat akoma nuk janë mbyllur për shkak të fluksit të votuesve në QV, kryesuesi pret përfundimin e procesit dhe me pastaj përmes Menaxherit të QV, bëhet raportimi i mbylljes së VV.

### Para Ditës së Zgjedhjeve

- Vijon trajnimin duke ushtruar dhe mësuar procedurat e votimit, numërimit dhe paketimit
- Studion dhe mëson procedurat e votimit dhe numërimit
- Njoftohet me KKZ
- Pranon materialin jo të ndjeshëm
- Rregullon Vendvotimin duke vendosur shenjat dhe tavolinat




### Para hapjes së Vendvotimit

- Pranon dhe kontrollon materialin e ndjeshëm
- Cakton detyrat e anëtarëve të KVV
- Para hapjes zyrtare të VV, shfaqë kutinë e votimit tek të pranishmit
- Vendos lidhëset e sigurisë në kuti
- Regjistron numrat në formular




## Hapja e Vendvotimit - Procesi I Votimit

- Në ora 07:00 shpall VV zyrtarisht të hapur për votim
- Shënon në Librin e votimit:
  - a) kohën e hapjes dhe emrat e anëtarëve të KVV-së.
  - b) emrat dhe numrat e DI-ve të akreditimit të vëzhguesve të pranishëm.
- Mbikëqyrë zhvillimin e procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim në përputhje me Ligjin//Rregullat e zgjedhjeve
- Siguron që të gjithë formularët e nevojshëm të jenë në vendvotim dhe të plotësohen në mënyrë të saktë.
- Raporton të dhënat për rezultatet preliminare
- Mban kontakte me vëzhgues dhe media.



## Mbyllja e Vendvotimit

- Mbyll derën e VV (19:00) në bashkëpunim me menaxherin e QV.
- Mbyll vrimen e kutisë me lidhëse të sigurisë
- Plotëson formularin/FRS.
- Cakton një anëtar të KVV te dera.
- Rregullon hapsiren/tavolinat për numërim.
- Mbikëqyrë procesin e numërimit.
- Mbikëqyrë paketimin e materialeve.
- Ofron kopjen e formularit tek Personeli i futjes së të dhënave të rezultateve preliminare.
- Transporton materialin e KVV në depon Komunale/QKN.



## **KONTROLLUESI I RRESHTIT**

Është përgjegjës për kontrollimin e gishtërinjve, për tu siguruar se nuk kanë shenjë matrikuluese para se të hyjnë në vendvotim.

**Kontrolluesi i rreshtit është përgjegjës për:**

- Këshillon votuesit të kontrollojnë se a janë duke pritur në vendvotim të duhur, dhe njëkohësisht konfirmon.
- Udhëzon votuesit të bëjnë gati dokumentet identifikuese.
- Tregon kujdes të shtuar me të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizara.
- Kontrollimin e gishtërinjve për shenje të ngjyrës matrikuluese.
- Drejton votuesin tek Zyrtari I Identifikimit.
- Menaxhon numrin e personave brenda VV.
- Mbyll derën e VV pasi të udhëzohet nga Kryesuesi.

**Kontrolluesi i rreshtit ka të drejtë të refuzoj votuesin të hyjë në VV në këto raste:**

- Kur zbulohet ngjyra matrikuluese në gishtërinj
- Kur votuesi refuzon kontrollimin e gishtërinjve
- Kur ndodhet në vV e gabuar, e orienton tek tavolina ndihmese në QV

## **ZYRTARI I IDENTIFIKIMIT**

Është përgjegjës për:

- identifikimin e votuesit në LV dhe verifikimin e identitetit të votuesit, duke i krahasuar të dhënat personale dhe fotografinë në dokumentin identifikues.
- udhëzimin e votuesit që të nënshkruar në hapësirën e dedikuar në LV
- e drejton votuesin të dhënësi i fletëvotimeve

## **ZYRTARI I TË DHËNAVE STATISTIKORE**

Është përgjegjës për:

- asiston zyrtarin e identifikimit
- grumbullimin e të dhënave statistikore të daljes së votuesve, sipas gjinisë dhe grupmoshave
- raportimin e të dhënave statistikore të kryesuesi i VV

## **DHËNËSI I FLETËVOTIMEVE**

Është përgjegjës për:

- shënjin me ngjyrë matrikuluese në gishtin e madh të dorës së djathtë të votuesit
- vulosjen e fletëvotimit dhe dhënien e fletëvotimit votuesit;
- udhëzimin e votuesit për mënyrën e votimit
- kontrollimin e fletëvotimeve të papërdorura, në rast se janë në gjendje të rregullt dhe i raporton kryesuesit të VV, nëse ka ndonjë fletëvotim të dëmtuar ose me gabime shtypi
- numërimin e amave të fletëvotimeve dhe raportimin tek kryesuesi i VV për fletëvotimet e përdorura dhe të papërdorura;
- mbajtjen e fletëvotimeve në gjendje të rregullt dhe të sigurtë



### Përtë votuar:

Votuesi duhet të ketë së paku **18 vjet**, të **dëshmojë identitetin** e vet përmes **Dokumentit identifikues të Republikës së Kosovës**, si dhe ta ketë emrin në Listën e Votuesve në vendvotim apo në Listën e Votuesve të Komunës përkatëse.

Votuesit i mohohet e drejta e votimit në rast se nuk prezanton ndonjërin nga dokumentet zyrtare të pranueshme.


Dokumente të vlefshme të votimit konsiderohen, të gjitha dokumentet e Republikës së Kosovës, siç i parasheh **neni 90 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme**.



### Dokumentet e pranueshme të identifikimit janë:

- Letërnjoftimi;
- Pasaporta;
- Leja e vozitjes;

## VOTIMI ME ASISTENCË




Nëse votuesi kërkon ndihmë për shkak se nuk din shkrim dhe lexim dhe nuk është në gjendje të shënojë fletëvotimin, udhëzohet ta gjejë një person, që e asiston dhe që është i moshës 18 vjeçare, me dokument identifikues të Republikës së Kosovës, dhe i njëjti ka të drejtë të ndihmojë vetëm një herë.

Kryesuesi i KVV-së shënon të dhënat personale të asistuesit dhe të votuesit të asistuar në Librin e Votimit, kohën dhe arsyen e asistimit.

Kryesuesi me anëtarët e KVV dhe vëzhguesit nuk kanë të drejtë të ndihmojnë votuesin.

IDENTIFIKIMI I VOTUESIT




Votuesi



## Procesi i Votimit të rregullt

Votuesi/ja hyn në vendvotim të duhur

Zyrtarë i Identifikimit



**HAPI 1**


Zyrtari i identifikimit i kërkon një **Dokument Identifikues (DI)** të pranueshëm.  
**Nënshkruhet në Listë të votuesve (LV)?**

Votuesi me DI

## IDENTIFIKIMI I VOTUESIT




## SPËRKATJA E GISHTIT ME LAPSIN MATRIKULUES DHE DHËNIA E FLETËVOTIMIT



**HAPAT E PUNËS SË ZYRTARIT PËR  
DHËNIEN E FLETËVOTIMIT**

# KUTIA E VOTIMIT DHE KABINA E VOTIMIT




## ANETARI PËRGJEGJËS PËR MBIQYRJEN E KUTISË SË VOTIMIT

Është përgjegjës për mbikqyrjen e kutisë së votimit dhe sigurohet që vetëm fletëvotimet e vulosura futen brenda.


### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sigurohet që vula zyrtare të jetë prapa fletëvotimit para se të futet në kutinë e votimit
- Sigurohet që votuesi të votoj sipas radhës dhe që vetëm një votues të jetë prapa kabinës së votimit në të njëjtën kohë.
- I orienton votuesit për dalje nga VV, pasi të kenë votuar.
- Sigurohet që gjatë tërë ditës së votimit kabinat e votimit të jenë të pajisura me stilolaps dhe me broshurat e kandidatëve dhe të sigurohet se ato janë në gjendje të rregullt.




### Kush mund të votojë?

- Votuesi duhet të dëshmojë se:
  - a) është 18 vjeç,
  - b) të jetë i regjistruar në Regjistrin Civil,
  - c) të dëshmojë identitetin e vet përmes Dokumentit të identifikimit të pranueshem,
  - d) emri i tij të jet i përfshirë në Listen e Votueseve në VV apo në Listen e Votueseve të Komunës përkatëse.



### Kush nuk lejohet të votojë?

- Votuesi i cili nuk është së paku 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve.
- Votuesi të cilit nuk i figuron emri në Listën e Votuesve (LV) të atij vendvotimi apo në Listen e Votueseve të Komunës përkatëse dhe nuk ka Dokument Identifikimi të pranueshem.
- Votuesi/ja që refuzon të nënshkruhet në LV; votuesit/es i refuzohet dhënia e fletëvotimit dhe rasti shkruhet në libër të votimit nga Kryesuesi.
- Votuesi nuk voton kur Kontrolluesi i Rreshtit zbulon ngjyrën matrikuluese në gisht të votuesit. Rasti shkruhet në libër të votimit nga Kryesuesi
- Votuesi refuzon t'i shënjohe gishti me ngjyrë matrikuluese, votuesit i refuzohet dhënia e fletëvotimit - udhëzohet jashtë; në LV te pjesa ku është nënshkruar bëhet me shejë dhe shlyhet nënshkrimi. Rasti shkruhet në libër të votimit.





# III PËRGATITJET PËR VOTIM

## PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

Në këtë kapitull janë përshkruar procedurat dhe obligimet e personelit zgjedhor, lidhur me përgatitjet e nevojshme për rregullimin e duhur të QV dhe VV.

Personeli Zgjedhor obligohet si në vijim:

Komisioni Komunal i Zgjedhjeve përmes ZEKKZ siguron dhe mbikëqyrë të gjitha përgatitjet zgjedhore në nivel të komunës duke siguruar se personeli zgjedhor i caktuar udhëzohet dhe pranon materialet zgjedhore sipas afateve të përcaktuara në planin operacional të aprovuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

### ZYRTARI EKZEKUTIV KOMUNAL ZGJEDHOR



ZEKKZ siguron dhe mbikëqyrë të gjitha përgatitjet për procesin zgjedhor të komunës përkatëse. ZEKKZ sigurohet se personeli zgjedhor bën pranimin e materialit sipas afateve të caktuara në planin operacional të aprovuar nga KQZ.

#### Menaxheri i QV

1. Vijn trajnimin për përgjegjësitë dhe obligimet e personelit të QV
2. Pranon pakon me materiale të QV-së nga Kryesuesit e Vendvotimit të rregullta dhe të dyfishta.
3. Një ditë para Dites së Zgjedhjeve vendos gjitha shenjat dhe udhëzimet përkatëse për votues.
4. Në bashkëpunim me KKZ-në dhe Policinë, kujdeset për sigurinë e materialit jo të ndjeshëm zgjedhor.
5. Siguron qasjen për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

#### Kryesuesi i KVV

1. Vijn trajnimin për procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotim.
2. Pranon pakon me materiale të VV-së nga KKZ
3. Një ditë para Dites së Zgjedhjeve vendos të gjitha shenjat dhe udhëzimet përkatëse për votues.

## MATERIALET E ZGJEDHJEVE DHE SHPËRNDARJA E TYRE

Një ditë Para Ditës së Zgjedhjeve ZEKKZ është i obliguar dhe përgjegjës për shpërndarjen e materialeve jo të ndjeshme tek Menaxherët e QV dhe Kryesuesit e VV.

Çdo material që dorëzohet/pranohet do të evidentohet në formularët zyrtar përkatës për pranimit/dorëzim, dhe e gjithë kjo duhet të bëhet në mënyre transparente. Çdo material duhet të kontrollohet/testohet bashkarish në mes të Kryesuesit të KVV dhe KKZ. Çdo vërejtje apo mungesë e materialit raportohet tek ZEKKZ/KKZ.

Materialet e zgjedhjeve ndahen në dy grupe: të ndjeshme dhe jo të ndjeshme. Materialet shpërndahen sipas planit operacional dhe udhëzimeve të SKQZ.

### MATERIALET PËR QENDËR TË VOTIMIT

Tabela në vijim ilustron llojet e materialeve që do të përdoren nga Menaxheret dhe personeli teknik i Qendrës së Votimit. Menaxheri i QV është përgjegjës para pranimit të kontrollohet/teston të gjitha materialet dhe të nënshkruaj në formular.

#### MATERIALE JO TË NDJESHME

##### Shpërndarja

Para  
Zgjedhjeve  
(-1 ditë)




- ✓ Lista e Votuesve në formatin elektronik
- ✓ Shabllon të "Brail" për votim të personave të verbër
- ✓ Shenjat dhe poster informues
- ✓ Materialet administrative (lapsa, marker, letër dhe ngjitës)
- ✓ Formular për ankesa në PZAP

#### MATERIALE TË NDJESHME

##### Shpërndarja

Në Ditën e  
Zgjedhjeve



- ✓ Tabletat e personelit për raportim të rezultateve preliminare

## MATERIALET PËR VENDVOTIM

Tabela në vijim ilustron llojet e materialeve që do të përdoren nga KVV në vendvotim. Kryesuesi është përgjegjës para pranimit të kontrollon/teston të gjitha materialet dhe të nënshkruaj në ular.

### MATERIALE JO TË NDJESHME

#### Shpërndarja

Para  
Zgjedhjeve  
(-1 ditë)



- ✓ Lista e Votuesve
- ✓ Lidhëset e sigurisë
- ✓ Libri i votimit
- ✓ Formulari i rezultateve të subjekteve-FRS
- ✓ Ngjyra dhe mbushësit
- ✓ Kabinat e votimit
- ✓ Kutitë e votimit

### MATERIALE TË NDJESHME

#### Shpërndarja

Në Ditën e  
Zgjedhjeve




- ✓ Fletëvotimet dhe broshurat e kandidatëve
- ✓ Lista e Votuesve
- ✓ Vula
- ✓ Lapsi matrikulues
- ✓ Kamera regjistruese

### MATERIALET E NDJESHME PËR PRANIM/DORËZIM


#### Shpërndarja

Në Ditën e  
Zgjedhjeve



- ✓ Zarfi i KKZ
- ✓ LV
- ✓ FRS
- ✓ Libri i Votimit
- ✓ Lidhëset e sigurisë
- ✓ Kutia e votimit
- ✓ Thesi 2 dhe 4
- ✓ Zarfi 1 dhe 3
- ✓ Vula
- ✓ Kamera regjistruese

## RREGULLIMI I QENDRAVE TË VOTIMIT DHE VENDVOTIMEVE



### Rregullimi i Vendvotimit

Kryesuesi së bashku me të gjithë anëtarët e KVV-së janë përgjegjës për përgatitjen dhe rregullimin e Vendvotimit një ditë para Zgjedhjeve, si në vijim:


- Largimin e çfarëdo materiali të fushatës zgjedhore
- Organizon tavolinat sipas skicës zyrtare të KQZ,
- Vendos kamerat regjistruese ne baze te skemës zyrtare te KQZ
- Mënyra e organizimit të VV, duhet te mundësoje qarkullim të lirshëm të votuesve dhe të ofroj transparence, ku anëtarët e KVV dhe vëzhguesit e zgjedhjeve të mund ta shikojnë tërë procesin e votimit dhe ti shohin qartë të gjithë kutitë e votimit gjatë tërë kohës.
- Kabinat e votimit vendosen në dy kënde të hapësirës, në atë mënyrë që të sigurohet që votuesi të mund të votojë në fshehtësi
- Vendos një kabinë votimi më të ultë për të mundësuar votim për personat në Karrocë

### Vendosja e shenjave dhe e njoftimeve

Njoftimet e mëposhtme duhet të ekspozohen kryesisht brenda dhe jashtë Vendvotimit:

- Vendos mbi derë ose në hyrje të vendvotimit shkronjat e alfabetit të mbiemrave të votuesve të caktuar të votojnë në atë vendvotim. (p.sh. votuesit te cilëve mbiemri ju fillon me A,B,C deri ne D votojnë këtu)
- Posterët "Si të shënjohet fletëvotimi", në kabinë të votimit dhe jashtë VV-ve
- Broshura e kandidatëve e cila vendoset në kabinë të votimit dhe mbi tavolinën e dhënësit të fletëvotimeve
- Posterët me listën e ndalesave që përfshijnë: ndalimin e armëmbajtjes, fotografimin e votës, konsumin e alkoolit dhe duhanit , votimin familjar dhe në grup

# VENDVOTIMI



Renditja e KVV-ve dhe Vëzhguesve në Vendvotim



## NË DITËN E ZGJEDHJEVE


Në Ditën e Zgjedhjeve QV dhe VV duhet të jenë të përgatitura dhe të gatshme për tu hapur në orën e përcaktuar zyrtarisht nga KQZ.

- ZEKKZ dhe anëtarët e KKZ janë përgjegjës për shpërndarjen e materialeve të ndjeshme tek Kryesuesit e VV.
- Menaxherët e QV janë përgjegjës për sigurimin e qarkullimit dhe orientimin e votuesve brenda QV.
- Kryesuesit e VV janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të votimit brenda vendvotimit, duke siguruar proces të qetë dhe transparent, përmes respektimit të drejtave të votuesve dhe akterëve tjerë të përfshirë në proces.


### Aktivitetet para hapjes së vendvotimit

#### 05:00-06:00

1. Kryesuesi së bashku me një anëtar tjetër, kontrollon, verifikon dhe pranon materialin e ndjeshëm nga KKZ duke u siguruar që asgjë nuk mungon.
2. Nënshkruan formularin e KKZ për praninë të materialeve
3. Në përcjellje të policisë transporton materialin në vendvotim




#### 06:00 - 07:00



1. Të gjithë anëtarët e KVV duhet të jenë prezent në vendvotimin e tyre në ora 06:00.
2. Të gjithë anëtarët e KVV Pranojnë materialet e tyre përkatëse nga Kryesuesi.
3. Rregullojnë vendvotimin sipas procedurave zyrtare të KQZ.
4. Shënojnë etiketat me kodin e VV
5. Në mungesë të ndonjë materiali zgjedhor ose ndonjë anëtar të KVV, kryesuesi informon KKZ përmes menaxherit të QV

## 06:00-deri në mbyllje të QV

1. Hap QV me kohë dhe delegon detyrat te personeli teknik
2. Siguron se shenjat orientuese dhe udhëzimet janë vendosur në vende të duhura
3. Shpërndan materialet jo të ndjeshme tek Kryesuesit
4. Rregullon tavolinën ndihmëse
5. Raporton në KKZ: Mungesat e stafit ose materialit; hapjen/mbylljen e QV/VV; daljen e votuesve në zgjedhje



### HAPJA E VENDVOTIMIT

Përbërja (KVV) reflekton strukturën e anëtarëve të (KKZ). Ekipi i KVV-së duhet të ketë 5 anëtarë, por ka raste kur me vendim të KKZ, vendvotimi mund të hapet edhe me 3 anëtar për të funksionuar procesi zgjedhor.

Detyrat e Kryesuesit para hapjes zyrtare të vendvotimit

#### Plotësimi i fletës së punës në FRS:

- Plotëson pjesën e parë-shkruan numrin e VV; numrat e shiritave për mbylljen e kapakut të kutisë së votimit. (Shih mostrat e FRS)
- Verifikon dhe plotëson numrin total të fletëvotimeve të pranuar

#### Shkruan në Libër të votimit:

- emrat, mbiemrat dhe numrat personal të anëtarëve të KVV si dhe të dhënat e vëzhguesve të akredituar të pranishëm

#### Udhëzon KVV dhe vëzhguesit:

- Udhëzon anëtarët e KVV të marrin materialet përkatëse për të filluar punën
- Vëzhguesve u rikujton obligimet dhe të drejtat e tyre si vëzhgues

#### Eksponon për të pranishmit:

- Kutinë e zbrazët të votimit
- Mbyll kutinë me kapak dhe shiritat përkatës, të cilët shënohen në pjesën e parë, rubrika tre te FRS

Pas këtyre hapave Kryesuesi i KVV-së shpall Vendvotimin zyrtarisht të hapur.

Orët e votimit janë: 07:00-19:00

### PARA SE TË VOTON VOTUESI I PARË

Kryesuesi dhe anëtarët e KVV mund të votojnë të parët, mirëpo vetëm pasi të hapet VV zyrtarisht, pra jo më herët se ora 07:00 (Rregulla Nr.11/2024-neni 12). Kryesuesi lejon që vetëm një anëtar i KVV të dal dhe votojë si i rregullt, por nëse anëtarët e KVV nuk janë duke shërbyer në QV ku zakonisht votojnë, mund të votojnë në vendvotimin me kusht.



# IV PROCESI I VOTIMIT (07:00-19:00)

## PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E VOTIMIT

Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë parasheh këto mënyra të votimit:

- 1) Votim të rregullt;
- 2) Votim me kusht;
- 3) Votim jashtë vendit
- 4) Votim për persona me nevoja të veçanta

### VOTIMI I RREGULLT



### Votimi me asistencë

Në kuader të votimit të rregullt hynë votimi me asistencë. Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, kur aftësia e tij e kufizuar dëshmohet përmes dokumenteve përkatëse, mund të ndihmohet nga një person tjetër (asistuesi) nga e njëjta QV, i zgjedhur nga votuesi.

Personeli Zgjedhor (KVV/Menaxheret, vëzhguesi i akredituar, personeli teknik etj.) nuk lejohen të ndihmojnë votuesit.

Këto raste shkruhen në libër të votimit nga Kryesuesi i cili duhet të mbajë evidencë të ndihmësve, sepse vetëm njëherë ju lejohet të ndihmojnë.

# V MBYLLJA E QENDRËS SË VOTIMIT DHE VENDVOTIMIT

## MBYLLJA E QENDRËS SË VOTIMIT

QV mbyllet në orën 19:00. Çdo person që gjendet në radhë brenda QV në momentin e mbylljes, i lejohe të votojë. Menaxheri i QV dhe kryesuesi i VV, sigurojnë që të gjithë ata që janë në radhë brenda QV, hyjnë në VV. Personi që vjen pas mbylljes së QV, nuk mund të votojë.

## MBYLLJA E VENDVOTIMIT (19:00)

- Kryesuesi i KVV është përgjegjës për mbylljen e VV, në orën e përcaktuar zyrtarisht nga KQZ (19:00), përjashtimisht pasi të votojë qytetari i fundit në radhë i cili ndodhet brenda QV.  
**Veprimet e menjëhershme pas mbylljes së VV**
- Kryesuesi udhëzon kontrolluesin e rreshtit ta mbyll derën dhe shpall VV zyrtarisht të mbyllur.
- Mbyll vrimen e kapakut të kutisë së votimit me shirit mbyllës dhe e shkruan numrin e shiritit në FRS dhe në libër të votimit.
- Shkruan në librin e votimit kohën e mbylljes së vendvotimit dhe të dhënat e personave të pranishëm. Njëkohësisht i njofton të pranishmit se, nëse largohen nga VV gjatë procesit të numërimit, atyre nuk ju lejohe të kthehen në VV, përveç anëtarëve të KVV, KQZ, KKZ, SKQZ.

**Vëmendje:** Pas mbylljes së vendvotimit, Kryesuesi i KVV-së nuk do të lejon askënd të hyjë brenda, përveç Zyrtarëve të autorizuar si: Anëtarët e KQZ, KKZ, Trajnerët e Sekretariatit Kryesuesi monitoron të gjithë personat që hyjnë dhe largohen nga vendvotimi.

### Veprimet para se të hapet kutia e votave

1. Numëron nënshkrimet e votuesve në LV dhe shumën e tyre e shkruan në pjesën përkatëse të fletës së punës të FRS (pjesa e dytë, rubrika pesë në FRS)
  2. Numeron fletëvotimet e mbetura/papërdorura dhe shumën e tyre e shkruan në pjesën përkatëse të fletës së punës të FRS (pjesa e dytë, rubrika gjashtë në FRS).
  3. Fletëvotimet e papërdorura paketohen së bashku me amat e fletëvotimeve, dhe vendosen në thesin nr. 2 i cili nuk mbyllet ende.
  4. Numëron fletëvotimet e dëmtuara dhe shumën e tyre e shkruan në fletën e punës të FRS (pjesa e dytë, rubrika shtatë në FRS), dhe të njëjtat paketohen në zarfin nr. 1 duke i plotësuar rubrikat e zarfit me shumën/sasinë përkatëse të fletëvotimeve.
  5. Para se të fillojë procesi i numërimit Kryesuesi udhëzon anëtarët e KVV që vulën dhe ngjyrën matrikuluese t'i vendosin në një thes plastik, që mbyllet me shiritin e sigurisë, numrat e të cilit shënohen në librin e votimit. Njëkohësisht, i gjithë materiali administrativ i përdorur gjatë procesit të votimit duhet të vendoset në një thes plastik, i cili mbyllet me shiritin e sigurisë dhe i njëjti shënohet në librin e votimit.
  6. Nëqoftëse në një VV ka më tepër se një kuti votimi, numërimi për kutinë e dytë fillon vetëm pas përfundimit të numërimit të kutisë së parë.
- Për fillimin e procesit të numërimit, kryesuesi së bashku me anëtarët e KVV rregullojnë/vendosin tavolinat në formë të shkronjës "T", në atë mënyrë që vëzhguesit e akredituar të mund të shohin qartë tërë procesin e numërimit.
  - Në rast të çdo mospërputhje, gjatë procesit të numërimit, duhet të rinumërohet edhe një herë nga anëtarët tjerë të KVV, sepse kryesuesi duhet të sigurohet që të dhënat në FRS të jenë të sakta.

Për plotësimin e fletës së punës dhe FRS është i autorizuar vetëm kryesuesi i KVV.

# VI NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE DHE PËRPUTHJA E REZULTATEVE


## HYRJE NË PROCEDURË TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

Numërimi i votave është proces shumë i rëndësishëm dhe i ndjeshëm sepse ndikon drejtpërdrejt në integritetin dhe besueshmërinë e procesit zgjedhor. Kryesuesi bashkë me anëtarët tjerë duhet të dëshmojnë profesionalizëm dhe kompetencë të lartë.


Në vijim prezantojmë parimet dhe rregullat universale ndërkombëtare lidhur me numërimin dhe përputhshmërinë e rezultateve të cilat vlejné dhe janë të aplikueshme edhe në Kosovë.

Sipas ligjit Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës , në VV zhvillohet procesi i numërimin të votave vetëm për subjektet politike.

### Përputhja 1:



### Përputhja 2:



### Përputhja 3:

Numri total i fletëvotimeve  
brenda në kuti të votave



## NUMËRIMI I VOTAVE TË SUBJEKTEVE POLITIKE

Kryesuesi bashkë me anëtarët tjerë të KVV janë përgjegjës për këto detyra:

### Hapi 1:

- Përgatit tavolinat dhe hapsirën ku do të numërohen votat duke lënë qasje për vëzhguesit
- Largon lapsat dhe gjërat tjera nga tavolina numërimit
- Kryesuesi vendos personelin e KVV në pozitat e tyre
- Sjellë kutinë e votave mbi tavolinë dhe lexon numrat e shiritave të sigurisë dhe i krahason me numrat e shkruar në FRS dhe në libër të votimit.

### Hapi 2:

- Kryesuesi pren shiritat anësor të kutisë së votave dhe i vendos në një vend të sigurt
- Zbraz fletëvotimet mbi tavolinë dhe i klasifikon në: të vulosura dhe të pavulosura
- Kryesuesi mbikëqyrë procesin e numërimit ku katër (4) anëtar numërojnë fletëvotimet duke i ndarë në dengje me nga 50 fletëvotime. Çdo deng me 50 fletëvotime numërohet dy (2) herë nga anëtarë të ndryshëm të KVV, për të konfirmuar dhe siguruar se numri është i saktë.
- Kryesuesi mbledhë numrin apo shumën totale të fletëvotimeve dhe e shkruan në fletën e punës/FRS.

**Vëmendje:** nëse ka fletëvotime të pavulosura, numërohen dhe shkruhen në libër votimi. Cdo fletëvotim i gjetur në kuti të votave i pavulosur cilësohet i pavlefshëm.

### Hapi 3:

- Kryesuesi krahason shumën totale të nënshkrimeve në LV të plotësuar në fletën e punës FRS/pjesa e dytë rubrika 5 me shumën totale të fletëvotimeve në kuti të votave në fletën e punës FRS/pjesa e dytë rubrika 8.

**Vëmendje:** Numri i nënshkrimeve në LV duhet të përputhet me saktësi me shumën totale të fletëvotimeve në kuti të votave, por nëse ka mospërputhje, atëherë ajo duhet të shkruhet dhe të sqarohet në libër të votimit.

Nëse ka mospërputhje, pranohet toleranca e mospërputhjes si në vijim:

- Deri në 100 nënshkrime në LV, tolerohet mospërputhje 1 (+/-)
- Deri në 200 nënshkrime në LV, tolerohet mospërputhje 2 (+/-)
- Më shumë se 200 nënshkrime në LV, tolerohet mospërputhje 3 (+/-)

#### Hapi 4:

- Klasifikimi i fletëvotimeve:



#### Fletëvotimi është i pavlefshëm nëse:

- Preferenca e votuesit për subjektin politik është e paqartë
- Është votuar për më shumë se një subjekt politik.
- Nëse nuk është vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimit.
- Nuk është votuar për subjektin politik, dmth mungon shenja për subjektin politik, por janë votuar vetëm kandidatët.

Në rastet kur anëtarët e KVV nuk pajtohen, vendimi i Kryesuesit është përfundimtar.

Kryesuesi informon të pranishmit për të drejtën e tyre për tu ankuar pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

#### Hapi 5:

- Fletëvotimet duhet të ndahen sipas subjekteve politike në dengje, duke i radhitur sipas numrit të subjektit.
- Numërimi fillon me subjektin e parë politik dhe shënohen votuat e fituara.
- Për t'u siguruar se numërimi është i saktë, çdo deng numërohet dy herë nga anëtarë të ndryshëm të KVV. Nëse nga dy numërimet, shuma e votave është e njëjtë, vazhdohet me dengun e radhës. Ndërsa nëse shuma nuk përputhet, atëherë dengun rinumërohet përsëri.
- Procesi vazhdon deri kur numërohen të gjitha dengjet e fletëvotimeve nga subjektet politike
- Kryesuesi shkruan në fletën e punës/FRS votat totale për secilin subjekt politik.
- Kryesuesi mbledhë votat e fituara nga gjitha subjektet politike dhe shumën totale e shkruan në fletën e punës/FRS.
- Kryesuesi kontrollon të dhënat dhe sigurohet se është arrit përputhja 3.

Në fund të procesit të numërimit në VV, kryesuesi i VV bën bartjen e të gjitha të dhënave nga fleta e punës në pjesën origjinale të FRS. Pas përfundimit të procesit të numërimit në VV, mbetet të plotësohet pjesa e paketimit dhe transportit të materialeve nga VV në KKZ, apo procedurat e pranimit dorëzimit.

# VII | FORMULARI I REZULTATEVE, PAKETIMI NE VV DHE TRANSPORTI NË KKZ/QKN

## FORMULARI I REZULTATEVE TË SUBJETEVE POLITKE

Pas procesit të numërimit, Kryesuesi i KVV i shkruan rezultatet e votave në FRS. Ekziston një formular i veçantë që duhet plotësuar nga Kryesuesi i vendvotimit. Ky formular është:

- Formulari i Rezultateve të Subjekteve (FRS). Shih shtojcën nr. xx

### Vëmendje:

FRS përmban një fletë pune. Kryesuesi gjatë mbarëvajtjes së procesit të votimit dhe numërimit, gjithmonë duhet të shkruaj së pari në fletën e punës dhe vetëm kur vërteton se të dhënat janë të sakta, i bartë në FRS origjinale. Në fund të procesit, Kryesuesi komunikon dhe prezanton rezultatet e VV, duke shkëputur kopjen rozë të FRS dhe e ekspozon brenda VV, për t'iu mundësuar vëzhguesve qasje në rezultate zyrtare të vendvotimit. Ndërsa kopja e verdhë shkëputet dhe i dorëzohet Menaxherit të QV, apo personelit për futjen e rezultateve preliminare në QV.

Kopja origjinale dhe e gjelbërt e FRS, vendosen në zarfin e KKZ për pranim/dorëzim.

## PAKETIMI NË VENDVOTIM

Kryesuesi bashkë me anëtarët tjerë të KVV janë përgjegjës për paktimin e materialeve zgjedhore sipas procedurave zyrtare dhe diagramit të paketimit.

### Hapi 1:

- Nxjerr diagramin e paketimit i cili është i shtypur në pjesën e prapme të FRS dhe i përmbahet procedurave të votimit dhe numërimit në VV.
- Përgatit materialet për paketim dhe pranim dorëzim: zarfet, thasët, kutinë e votimit, shiritat mbyllës, vula, kamerat regjistruese, ngjyra matrikuluese dhe shkruan kodin/numrin e vendvotimit në çdo zarf/thes.

### Hapi 2:

- Vendos materialet zgjedhore sipas udhëzimeve në Diagram të paketimit të cilat nuk i mbyllë menjëherë.
- Në çdo tiketë të zarfit apo thesit shkruan shumën apo sasinë e fletëvotimeve që janë rënda
- Në FRS shkruan numrat e shiritave mbyllës për thasët 2 dhe 4 të cilët mbyllën me shirit
- Në FRS shkruan numrat e shiritave mbyllës të kapakut të kutisë së votave
- Fletëvotimet e përdorura, të vlefshmet sipas subjekteve politike lidhen me spango dhe futen në thesin nr. 4.
- Para se ti mbyll zarfet/thasët apo kutinë, kontrollon dhe vërteton se paketimi është bërë sipas udhëzimeve në diagramin e FRS dhe procedura.
- Kontrollon se a janë nënshkruar të gjithë anëtarët e KVV në FRS.

### Hapi 3:

- Mbyll zarfet, thasët, kutinë e votave dhe bëhen gati për transport.
- Paketon materialin jo të ndjeshëm në një thes.

**Hapi 4:**

- Kryesuesi së bashku me një anëtar të KVV nga subjekti tjetër politik është përgjegjës për dërgimin e materialit zgjedhor në Depon Kumunale.

**Vëmendje:**


Nëse paketimi bëhet sipas udhëzimeve, pranimi/dorëzimi i materialeve në depo komunale do të shkojë me lehtësi. Në të kundërtën, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) mban të drejtën të kërkoj nga Kryesuesi ti ri-paketoj përsëri materialet në depo.

## **VIII** TRANSPORTI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA KVV NË DEPO KOMUNALE/QKN

Sipas udhëzimeve të KKZ-së, ose Menaxherit të QV, Kryesuesi dhe një nga anëtarët e KVV-së, do t'i transportojnë të gjitha materialet zgjedhore përfshirë edhe zarfin e KKZ-së deri në depon komunale të KKZ-së.



## MATERIALET PËR TRANSPORT NGA VV I RREGULLT



## ARTIKUJT QË VENDOSEN NË KUTINË E VOTIMIT



Kutia e votimit duhet të pakëtohet si në diagramin e paraqitur më lartë. Vula, Lapsi matrikulues dhe Zarfet me thasët me numra përkatës, vendosen në kuti në atë mënyrë që të mund të shihen nga jashtë, pasi që kontrolli përmes shikimit bëhet gjatë pranimit të materialeve në depon komunale të KKZ-së.

# SHTOJCA 1: FORMULAR I REZULTATEVE TË SUBJEKTEVE (FRS)

ZGJEDHJET E RREGULLTA PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 9 SHKURT 2025 - IZBORI ZA SHUPËSTINË REPUBLIKE KOSOVO  
FLETË PUNE / RADNI LIST

111. FC PRISHTINA		112. FC DRITA		113. FC KASTRIOTI		114. FC VLLAZNIMI		115. FC BESA		116. FC BASEL		117. FC LUGANO		118. FC INTER		119. FC JUVENTUS		120. FC MILAN		121. FC UDINESE		122. FC LYON		123. FC BAYERN		124. DUALIPA		
Votat / Glasimet																												
1	Numeri i vendësimit Broj broshçog mesta																											
2	Numeri i shërbimit për mbajtjen e kështjellës së votimit Brojevi trasa za zadržavanje področja glasovačih listica																											
3	Numeri i shërbimit për mbajtjen e vëllimit të listës së votimit Broj trasa za zadržavanje otkaza na glasovačij listi																											
4	Numeri i fletëvotimitve të pranuar Broj primljenih glasovačih listica																											
5	Numeri i rinaktivimitve në Listën e Votimeve Broj popisa u Biradnom Spisku																											
6	Numeri i fletëvotimitve të nevaliduara Broj neiskorišćenih glasovačih listica																											
7	Numeri i fletëvotimitve të demtuar gjatë ditës Broj glasovačih listica otkazanih tokom dana																											
8	Numeri i fletëvotimitve bërçada në total të votimit Broj glasovačih listica u glasovačij listi																											
9	Dallimi në mes Rubrikës 5 dhe 8 Razlika između Rubrike 5 i 8																											
10	Numeri i fletëvotimitve të zbrozura / papërcaktuara dhe përfshirë (brenda listës) Broj praznin / nepopunjenih glasovačih listica i nevažeđi (u listi)																											
11	Numeri i fletëvotimitve të veprimeve Broj važeđih glasovačih listica																											
12	Gjithësi fletëvotimes të papërcaktuara, të përfshirë dhe të veprimeve (10+11) Ukupani broj nepopunjenih glasovačih listica, nevažeđih i važeđih (10+11)																											
13	Gjithësi (8+7+12) Ukupno (8+7+12)																											
14	Dallimi në mes Rubrikës 4 dhe 13 Razlika između Rubrike 4 i 13																											

PJESA 5: QKN || DEO 5: OCP  
Kyvesuel (Emri, Mbiemri | Nënshtkrimi) / Predsedavajući (Ime, Prezime | Pozipla)  
Anëtarët (Emri, Mbiemri | Nënshtkrimi) / Članovi (Ime, Prezime | Pozipla)

FRS për Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës

## SHTOJCA 2: FORMULAR I DORËZIM-PRANIMIT



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission  
Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo

### Formulari i dorëzimit-pranimit të materialit Obrazac za primopredaju materijala

Me këtë vërtetohet se kam marrë / Ovim potvrđujem da sam primio/la

1. Numri i fletëvotimeve  
Broj glasačkih listića
2. Lista e votuesve me kusht  
Uslovnih Birački spisak  faqe  
strane
3. Vula e fletëvotimeve  
Peçat za glasačke listiće  Po  
Da
4. Lapsi matrikular  
Matrikulama boja  Po  
Da
5. Kamera regjistruese  
Kamera za snimanje  Po  
Da Numri serik  
Serijski broj \_\_\_\_\_
6. Për vendotimin numër  
za broj biračkog mesta
7. Dhe konfirmoj se i kam kontrolluar dhe marrë të gjitha materialet jo të ndjeshme  
I potvrđujem da sam proverio i dobio sav neosetljivi materijal  Po  
Da

Kryesuesi i këshillit të vendotimit ose zëvendëskryesuesi  
Predsedavajući biračkog odbora ili zamenik predsedavajućeg

8. Emri dhe mbiemri  
Ime i prezime \_\_\_\_\_

9. Nënshkrimi  
Potpis \_\_\_\_\_

Anëtar i KKZ-së  
Član OIK-a


10. Emri dhe mbiemri  
Ime i prezime \_\_\_\_\_

11. Nënshkrimi  
Potpis \_\_\_\_\_

Formulari i dorëzimit-pranimit të materialit për Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës

## SHTOJCA 3: DIAGRAMI I PAKETIMIT

### DIAGRAMI I PAKETIMIT / DIJAGRAM ZA PAKOVANJE



Diagrami i Paketimit për Kuvend të Kosovës



## SHTOJCA 5: FORMULARI I ANKESËS I PZAP-së



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

### Formulari i Ankesës

E rezervuar për PZAP-in

NUMRI I REGJISTRIT TË VENDIMEVE \_\_\_\_\_

Shih faqen vijuese për udhëzime të hollësishtme lidhur me mënyrën e parashtrimit të ankesave

#### A. IDENTIFIKIMI I PARASHTRUESIT TË ANKESËS

Nëse parashtruesi i ankesës është organizatë apo subjekt politik:

1. Emri i organizatës/subjektit politik që parashtron ankesën \_\_\_\_\_
2. Emri i personit të caktuar për kontaktim \_\_\_\_\_
3. Posti i personit të caktuar për kontaktim \_\_\_\_\_
4. Adresa \_\_\_\_\_
5. Komuna \_\_\_\_\_
6. Nr. i telefonit \_\_\_\_\_ 7. Nr. i faksit \_\_\_\_\_
8. E-maili \_\_\_\_\_

Nëse parashtruesi i ankesës është individ:

1. Emri \_\_\_\_\_
2. Përkatësia politike nëse i përket ndonjë subjekti politik \_\_\_\_\_
3. Adresa \_\_\_\_\_
4. Komuna \_\_\_\_\_
5. Nr. i telefonit \_\_\_\_\_ 6. Nr. i faksit \_\_\_\_\_
7. E-maili \_\_\_\_\_
8. Data e lindjes   /   /     9. Numri i regjistrimit civil/ si votues

#### B. KRYESI I SUPOZUAR I SHKELJËS

Nëse kryesi i supozuar është individ/organizatë apo subjekt politik:

1. Emri i individit/organizatës apo subjektit politik \_\_\_\_\_
2. Posti zyrtar i personit, nëse ka të tillë \_\_\_\_\_
3. Adresa \_\_\_\_\_
4. Komuna \_\_\_\_\_
5. Nr. i telefonit \_\_\_\_\_ 6. Nr. i faksit \_\_\_\_\_
7. E-maili \_\_\_\_\_

### C. SHKELJAJ/SHKAKU I ANKESËS

Përshkrimi i ankesës tuj në hollësi, duke përfshirë vendin, datën dhe kohën e shkëlqes së përkrahur në ankesën tuaj në hollësi, duke përfshirë vendin, datën dhe kohën e shkëlqes së përkrahur. Lufoni ta përshkruani natyrën e shkëlqes dhe nëse është e mundur të specifikoni dispozitat ligjore që mendojnë se janë shkelur. Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjiti fletë shtesë. Bashkëngjitur dërgoni kopjet e çfarëdo dëshmie që mbështet ankesën tuaj.

### D. DËSHMITARI (ËT) E MUNDSHËM (BASHKANGJITUR EDHE DEKLARATAT)

Lutemi të shënojnë emrin dhe organizatën ose subjektin politik të cilit i përket dëshmitari(ët) i/e mundshëm. Nëse është e mundur, duhet të shënohen të dhënat për kontaktin (adresa, numri i telefonit, numri i faksit dhe e-maili). Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjiti fletë shtesë.

Sipas njohurive që une posedoj, informacioni i mësipërm është i saktë.  
(Nëse parashtruesi i ankesës është organizatë ose subjekt politik, atëherë atë duhet ta nëshkruaj përfaqësuesi i autorizuar)

Emri dhe Mbiemri

Nëshkrimi

Data

### PARASHTRIMI I ANKESAVE PRANË PZAP-IT

Çdo person, i cili ka interes ligjor ose që pohon se i janë shkelur të drejtat që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, mund të parashtrorj ankesën pranë Panelit të Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP). Kjo në mes tjerash, përfshin, por nuk kufizohet në:

- Aplikantët;
- Votuesit;
- Partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e certifikuar;
- Anëtarët e KOZ-së dhe të Sekretariatit të tij;

Për të parashtruar ankesë, duhet të plotësohet formulari i PZAP-it për ankesa. Formulari i ankesave është në dispozicion në gjuhën Shqipe dhe Serbe, në zyrën e PZAP-it në Prishtinë, si dhe në të gjitha Qendrat e Votimeve gjatë ditës së zgjedhjeve.

Që të shqyrtohet kjo ankesë, ajo duhet të përmbajë informatat vijuese:

- Pothimin mbi shkeljen e një rregullore të zgjedhjeve, ose të ndonjë urdhërese administrative që ka të bëjë me procesin zgjedhor;
- Përshkrimin sa më të hollësishëm të pohimit mbi shkeljen/incidentin; dhe
- Nëshkrimin në formular që tregon se të dhënat janë të sakta sipas njohurisë së parashtruesit të ankesës.

Duhet të plotësohen të gjitha rubrikat e zbatueshme të formularit. Nëse ndonjë rubrikë nuk mund të zbatohet, atëherë duhet të shënohet si "e pazbatueshme".

Është me rëndësi të jepen të dhënat për kontaktim të parashtruesit të ankesës, në mënyrë që PZAP-i mund të kontaktojë me parashtruesin e ankesës në rast hetimi dhe pasi të jetë marrë vendimi përfundimtar përkthazi me ankesën.

Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet brenda tri ditësh pas pohimit mbi shkeljen ose pasi të jetë i informuar parashtruesi i ankesës për atë shkelje.

Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë.

Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në Qendren e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkëlqes së supozuar.

Parashtrimi i ankesës bëhet drejtpërdrejt në zyrën qendrore të PZAP-it në Prishtinë. Po ashtu ankesat mund të lihen në kutitë postare të PZAP-it që gjenden në Prishtinë dhe në Zyrën e Sekretariatit të PZAP-it. Vendimet përfundimtare të PZAP-it bëhen publike; megjithatë dosjet e lëndëve mbeten plotësisht konfidenciale dhe të gjitha hetimet janë konfidenciale.

Ky informacion duhet të dorëzohet në adresën: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP)

Rruga "Luan Haradinaj", Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës - Kati I

Prishtinë 10 000 Republika e Kosovës

## SHTOJCA 6: UDHËZUES PËR REGJISTRIMIN ME KAMERË NË VV



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission  
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo

### Udhëzues për regjistrimin me kamerë në ditën e zgjedhjeve në vendvotim

#### I. Para hapjes së vendvotimit

1. Secili kryesues i vendvotimit së bashku me materialet tjera pranon një set të kamerës dhe pajisjeve përcjellëse, që përbëhet nga :
  - a) Strukturë me baze metalike dhe bosht te lëvizshëm që mundëson ngritjen e kamerës në lartësinë e nevojshme, e cila ka po ashtu një kuti me bllok ushqimi dhe bateri të karikueshme dhe një kablo të rrymës;
  - b) Kamera vëzhguese së bashku me kartelë memorie të instaluar;
  - c) Zgjatues i rrymës;
2. Kryesuesi verifikon nëpërmjet ngjitësit të vendosur tek koka e kamerës, dhe në strukturë se a përputhet numri i vendvotimit.

#### II. Para fillimit të procesit të votimit:

3. Kryesuesi e pozicionon kamerën në vendin këndin e vendvotimit përballë kabinave të votimit.
4. Ngre lart shulin e mbajtësit dhe e fikson në mënyrë që kamera të monitorojë ambientin e vendvotimit.
5. Pozicionon dhe fikson syrin e kamerës nga ambienti i vendvotimit.
6. Vendos në prizë furnizuesin me energji elektrike dhe konfirmon dritën jeshile tek kutia e baterisë.
7. Realizon lidhjen e kabllot së kamerës me kabllon ushqyese të rrymës që gjendet në strukturë metalike.
8. Shikon dritën e kuqe që ndizet tek kamera.
9. Nga ky moment kamera fillon regjistrimin.

#### III. Pas përfundimit të procesit të numërimit, Kryesuesi i vendvotimit:

10. Kryesuesi shpëput kabllon e rrymës të kamerës nga ushqyesi i energjisë.
11. Heq nga priza dhe shpëput nga rrjeti elektrik kutinë e baterisë.
12. E ul shulin e mbajtësit te kamerës.
13. Kamerën bashkë me materialet e tjera e transporton në depo.

Për çfarëdo problemi procedural apo teknik në lidhje me kamerat, ju mund të telefononi në Qendrën e Thirrjeve në KQZ







KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

# PROCEDURAT E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT NË VENDVOTIM



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, dhe nenin 87 paragrafi 7 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe neni 8 paragrafi 4 dhe nenin 9 Rregullores Zgjedhore Nr.10/2024 Fletëvotime dhe Broshurat në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 15.01.2025, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për Miratimin e Vizitave Zyrtare për Mbikëqyrjen e Procesit të Shtypjes së Fletëvotimeve, Broshurave dhe Listës Përfundimtare të Votuesve**

- I. Miratohen vizitat zyrtar e anëtarëve të KQZ-së dhe stafit të SKQZ-së për mbikëqyrjen e procesit të shtypjes së Fletëvotimeve, Broshurave dhe Listës Përfundimtare të Votuesve, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen shkurt 2025.
- II. Pjesëmarrës në këtë vizitë janë:
  - 1.Njëmbëdhjetë (11) anëtarët e KQZ
  2. Zyrtarët nga SKQZ sipas autorizimeve nga Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së
- III. Vizita do të realizohet në mënyrë periodike, dhe në grupe të ndara varësisht prej nevojave dhe kërkesave të KQZ-së.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.01.2025

**Kreshnik RADONIQI**  
  
**Kryesues i KQZ**





**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 dhe nenin 96 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregulloren Zgjedhore Nr.17/2024 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 15.01.2025, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për Miratimin e Vizitave Zyrtare për Vëzhgimin e Kutive Postare Jashtë Kosovës**

- I. Miratohen vizitat zyrtar e anëtarëve të KQZ-së dhe stafit të SKQZ-së për vëzhgimin e kutive postare jashtë Kosovë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen shkurt 2025.
- II. Pjesëmarrës në këtë vizitë janë:
  - 1.Alban Krasniqi
  - 2.Arianit Elshani
  3. Zyrtarët nga SKQZ sipas autorizimeve nga Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së
- III. Vizita do të realizohet në mënyrë periodike varësisht prej nevojave dhe kërkesat e KQZ-së.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.01.2025





**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 54, nenin 63 dhe nenin 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 2 të Rregullores Zgjedhore Nr. 08/ 2024 Vëzhguesit e Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 15.01.2025, nxjerr këtë:

### **VENDIM**

#### **Për Zgjatjen e Afatit për Akreditimin e Vëzhguesve të Subjekteve Politike**

- I. Miratohet zgjatja e afatit për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve politike, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 Shkurt 2025.
- II. Afati zgjatet nga data 15 janar 2025 deri më 20 janar 2025.
- III. Obligohet Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.01.2025

**Kreshnik RADONIQI**  
  
Kryesues i KQZ



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64 paragrafi 2.5 dhe nenin 87 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe neni 7 paragrafi 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.10/2024 Fletëvotimet dhe Broshurat, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 15.01.2025, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për Miratimin e Numrit të Fletëvotimeve, Broshurave dhe Listave  
Votuese**

- I. Miratohet numri i fletëvotimeve, broshurave dhe listave votuese, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.
- II. Numri i fletëvotimeve, broshurave dhe listave votuese si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.01.2025





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission  
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

## Numri i fletëvotimve, broshurave të kandidatëve dhe listave të votuesve që shtypen për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025

<b><u>Fletëvotimet që shtypen për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025</u></b>	<b><u>1,752,650</u></b>
Numri i fletëvotimeve në vendvotimet e rregullta	1,664,100
Numri i fletëvotimeve në vendvotimet me kusht	28,450
Numri i fletëvotimeve rezervë dhe VPNV	38,650
Numri fletëvotimeve në vendvotimet në përfaqësi diplomatike	21,450
<b><u>Broshura të kandidatëve që shtypen për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025</u></b>	<b><u>16,980</u></b>
Broshura të kandidatëve në vendvotimet e rregullta	15,198
Broshura të kandidatëve në vendvotime me kusht	336
Broshura të kandidatëve rezervë	1,170
Broshura të kandidatëve në përfaqësi diplomatike	276
<b><u>Lista të votuesve që shtypen për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025</u></b>	<b><u>2,635</u></b>
Lista të votuesve në vendvotimet e rregullta	2,533
Lista të votuesve në vendvotime me kusht	56
Lista të votuesve në vendvotimet në përfaqësi diplomatike	46



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 96 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Rregulloren Zgjedhore Nr.17/2024 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 15.01.2025, nxjerr këtë:

### **VENDIM**

#### **Për Miratimin e një Vendvotimi Shtesë në Qendrën e Votimit në Bernë dhe një në Qendrën e Votimit në Gjenevë dhe Mbylljen e një Vendvotimi në Qendrën e Votimit në Stokholm**

- I. Miratohet shtimi i një (1) vendvotimi në Qendrën e Votimit në Bernë dhe një (1) vendvotimi në Qendrën e Votimit në Gjenevë, ndërsa në përfaqësinë diplomatike në Stokholm për shkak të numrit të vogël të votuesve të regjistruar, nga dy (2) vendvotimet e miratuara fillimisht, do të mbetet vetëm një (1) vendvotim, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.
- II. Rekomandimi si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.01.2025

**Kreshnik RADONIQI**  
*[Signature]*  
Kryesues i KQZ





**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64.2 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 15.01.2025, nxjerr këtë:

### VENDIM

#### Për Miratimin e Planit Operacional të Sigurisë

- I. Miratohet Plani Operacional i Sigurisë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen 9 shkurt 2025.
- II. Plani si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimit.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.01.2025





**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 96 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 10 të Rregulloren Zgjedhore Nr.17/2024 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 15.01.2025, nxjerr këtë:

### VENDIM

#### **Për Miratimin e Ekipeve të Autorizuara për Tërheqjen e Dërgesave Postare Jashtë Kosovës**

- I. Miratohen ekipet e të autorizuara për tërheqjen e dërgesave postare jashtë Kosovës, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 Shkurt 2025.
- II. Lista e ekipeve si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.01.2025

**Kreshnik RADONIQI**  
  
**Kryesues i KQZ**